



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMËVE E STATISTIKËS

Nr. 540/4 Prot.

Fier, më 18.09. 2023

RAPORT MONITORIMI

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

PËRMBLEDHËSE

(JANAR – PRILL 2023)

Detajimi i buxhetit për vitin 2023 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Detajimi i fondeve për vitin 2023 është realizuar sipas tre programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektivave të programit të Qeverisë Shtator 2022, objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2022 dhe strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe kërkesave për imlementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Monitorimi i buxhetit të Vitit 2023 është procesi i vlerësimit të përfundimit, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të përfundimit me treguesit e planifikuar dhe ka për qëllim:

- Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në institucionet arsimore të varësisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike në juridiksionin e saj të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të vlerësojë nëpërmjet ZAVP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kriterëve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.
- Të sigurojë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- Të ofrojë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- Të menaxhojë dhe mbikëqyr/kontrollon institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e veprimtarive mësimore.
- Të monitorojë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- Të menaxhojë me përgjegjësi rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimit e analizimit të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- Të organizojnë dhe mbështesin shërbimin psikosocial në institucionet arsimore publike.

- Të garantoj mirë administrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.
- Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
- Të monitorojë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- Të organizoj dhe mbështes zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- Të inspektojnë, monitorojnë, vlerësojnë, rekomandojnë dhe nxjerrin përfundime mbi zbatueshmërinë e kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private.
- Të mbledh dhe përpunoj të dhënat statistikore nga institucionet arsimore në juridiksionin e tyre.
- Të krijojë një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin rajonal (DAR/ ZA), lokal (institucionet arsimore)
- Të vendos mekanizma transparente të monitorimit të përdorimit të fondeve buxhetore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të rrisë dhe zhvillojë kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier dhe 13 ZVAP-e në juridiksion të saj kanë filluar aktivitetin më 20.05.2019, bazuar në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”* dhe në Urdhërin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr 234, datë 19.04.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”*

Buxheti i DRAP Fier dhe 13.ZVA-et në juridiksion është mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe në fondet buxhetore të alokuara për vitin 2023 dhe të rishikuar gjatë vitit 2023, si dhe në prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë, i cili ndahet në tre programe si më poshtë:

- **01110 - Planifikim menaxhim**
- **09120 - Arsimi Bazë**
- **09320 - Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)**

Monitorimi i buxhetit të 4 m I të vitit 2023 është realizuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Zbatimi i buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore. Realizimi i treguesve të buxhetit, analizimi dhe krahasimi me vitet e kaluara.

DRAP Fier dhe 13 ZVA-et në juridiksion të saj është përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryen disa detyra të përcaktuara një ndër to është *“Garantimi i miradministrimit të burimeve financiare dhe alokimin e tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore”*.

Për të përmbushur detyrat ne kemi bërë parashikimet e nevojshme buxhetore, kemi hartuar projekt-buxhetin afatmesëm 2023-2025 sipas nevojave të institucionit dhe e kemi dërguar pranë MASR.

Në vijim po ju paraqesim fondet e akorduara dhe realizimet e shpenzimeve buxhetore në total dhe për cdo program buxhetor, sipas produkteve dhe llogarive ekonomike.


Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, po administron dhe menaxhon për vitin 2023 fondet buxhetore të rishikuara, për 13 ZVAP në vartësi të saj sipas llojit të shpenzimeve, në total 5 miliard e 749 milionë e 594 mijë lekë, krahasuar me shpenzimet faktike të 2022 në 6,048,429 ose 5 % ose 298 milion 834 mijë leke më i ulët se fakti i 2022 të ndarë për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime të tjera, ku peshën më të madhe e zënë pagat dhe sigurimet me 81.6% dhe 14.6%, kurse 602 zë vetëm 3.6%, transferte tek individët 3.3% dhe 231 zë 0.1% ndaj planit total.

Pesha specifike e shpenzimeve

Emertimi	Plani 2023	Peshe specifike
Paga	4,693,793	81.6%
Sigurime Shoqërore	840,760	14.6%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	208,444	3.6%
Transferte te individët	2,348	0.04%
Shpenzime kapitale	4,250	0.1%
Totali	5,749,595	100%

Më poshtë po paraqesim grafiksht sasinë e planit të rishikuar 2023 të ndarë përkatësisht për paga, sigurime dhe shpenzime të tjera.


Peshe specifike e shpenzimeve të planifikuara



Sasia dhe pesha specifike që ka cdo ZVAP është në vartësi të numrit të mësuesve dhe nxënësve, ku peshën më të madhe e kanë Fieri me 19.5 %, Vlora me 17.9 % dhe Lushnja 14.5% Kurse peshën më të vogël e ka DRAP Fier me 0.6 % dhe Finiq Dropull me 2 %.

Peshe specifike	Shuma	Institucioni
0.6%	33,514	Drap Fier
19.5%	1,122,111	Fier
3.6%	205,247	Patos
4.1%	235,292	Roskovec
5.0%	286,842	Mallakastri
14.5%	834,400	Lushnja
7.2%	414,936	Divjake
17.9%	1,030,276	Vlora
3.9%	223,005	Selenica
5.3%	305,241	Tepelena
3.5%	203,603	Permet
6.2%	355,250	Gjirokaster
6.7%	383,215.0	Saranda
2.0%	116,662	Finiq
100%	5,749,595	Totali

Paraqitja e peshes specifike që ka cdo institucion nda planit total të rishikuar 2023



Edhe paraqitja grafike shpreh qartë peshën specifike si në tabelë.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, ka realizuar fondet buxhetore, sipas tre programeve të miratuara, si më poshtë:


DRAP Fier ka **realizuar për vitin 2022** në total fondin prej 6 miliard 48 milion e 429 mijë lekë të ndarë sipas programeve të Planifikim menaxhimi 10110 në shumën 114 milion 436 mijë lekë, në arsimin bazë 4 miliard 688 milion 23 mijë lekë, kurse në arsimin e mesëm ka realizuar fondin prej 1 miliard 245 milion 969 mijë lekë, pra peshën më të madhe e zë Arsimi bazë.

Per **vitin 2023 plani total i rishikuar** është 5 miliard 749 milionë e 595 mijë lekë ose 298 milion 834 mije lekë më pak se realizimi i vitit 2022. Edhe këtë vit sasinë më të madhe të planit e ka Arsimi bazë vlerën 4 miliard 363 milion 345 mijë lekë, kurse sasinë më të vogël e ka planifikim menaxhimi, në vlerën 122 milion lekë.


Realizimi i 4 mujorit të I të vitit 2023, krahasuar me planin e rishikuar të këtij viti është 1 miliard 995 milion 176 mijë lekë nga 5 miliard 749 milionë e 595 mijë lekë plani ose 34.7 %. Programi 10110 është realizuar në masën 37 milion 795 mijë lekë nga 122 milion lekë plani ose 30.9 % , Arsimi bazë është realizuar në masën 1 miliard 542 milion 550 mijë lekë nga 4 miliard 363 milion 345 mijë lekë plani ose 35.4 % dhe Arsimi i mesëm është realizuar në masën 0 miliard 414 milion 832 mijë lekë nga 1 miliard 263 milion 921 mijë plani ose 32.8 %.

Emertimi	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	Real. vjetor/ Planit
Programi 01110	114,436	122,329	37,795	30.9%
Programi 09120	4,688,023	4,363,345	1,542,550	35.4%
Programi 09230	1,245,969	1,263,921	414,832	32.8%
Totali	6,048,429	5,749,595	1,995,176	34.7%

Më poshtë po paraqesim grafikun e tabelës për të krahasuar realizimin 2022 me planin e rishikuar 2023.



Krahasimin e realizimit 4M me planin e rishikuar të vitit 2023 po e paraqesim në grafikun e mëposhtëm.



Edhe në grafik duket qarte se peshen specifike e zë Arsimi Bazë. Tani vazhdojmë me një analizë më të hollësishme sipas programeve.

1. Planifikim menaxhimi 10110

Në programin 10110 në DRAP Fier (për 14 institucionet) plani i rishikuar i vitit 2023 në total është 122 milion 328 mijë lekë nga 114 milion 436 mijë lekë realizimi i vitit 2022, pra më i madh, me një rritje në vlerën 7 milion 892 mijë lekë. Ky plan është celur sipas kodeve të produkteve, ku vendin kryesor e zë produkti Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore me kodin 91101AE me shumën 107 milion 518 mijë lekë ose 95.42 % e totalit i ndjekur nga punonjes dhe specialist të trajnuar me kod produkti 91101AA në shumën 5 milion 397 mijë lekë ose 4.41% dhe produkti Drejtues të institucioneve arsimore të trajnuar me kodin 91101AC në shumën 200 mijë lekë ose 0.16 % nga totali.

Realizimi i vitit 2023 krahasuar me planin e celur të këtij viti në programin 10110 në total është 37 milion e 795 mijë lekë nga 114 milion e 436 mijë lekë plani ose 30.9 %. Në kodin e produktit 91101AE është realizuar në shumën 37 milion 177 mijë lekë nga 116 milion 661 mijë lekë plani ose 31.87 %. Në kodin e produktit 91101AA është realizuar në shumën 0 milion 618 mijë lekë nga 5 milion 467 mijë lekë plani ose 13.16 %.

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme:

K.Produktit	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	P,spec Pl.	% F/Pl
91101AA	2,566	5,467	618	4.47%	11.30%
91101AC	0	200	0	0.16%	0.00%
91101AE	107,518	116,661	37,177	95.37%	31.87%
18BC409	4,352	0	0	0.00%	#DIV/0!
Totali	114,436	122,328	37,795	100.00%	30.90%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave:





Tabela e situacionit të shpenzimeve për personelin dhe pesha specifike ndaj totalit

Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës	PBA Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti I periudhës progresive	% F / PI
600	Paga	83,068	100,752	90,342	28,587	31.64%
601	Sigurimet	14,003	16,227	15,087	4,827	32.00%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	11,065	21,691	16,799	4,280	25.48%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,947	310	100	100	100.00%
231	Investime	4,353	11,300	0	0	#DIV/0!
	Totali	114,436	150,280	122,328	37,795	30.90%
600	Paga	72.59%	67.04%	73.85%	75.64%	
601	Sigurimet	12.24%	10.80%	12.33%	12.77%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	9.67%	14.43%	13.73%	11.33%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.70%	0.21%	0.08%	0.26%	
231	Investime	3.80%	7.52%	0.00%	0.00%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara per personelin janë 122 milion e 328 mijë lekë nga 114 milion 436 mijë lekë realizuar në 2022 ose me shtesë 6.9 %.

Ne fondet e realizuara fondi i pagave zë peshen 75.64 %, sig.shoqërore 12.77%, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 11.33 %, transfertat për buxhetin familjar 0.26 % dhe Investime 0%.

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave



2. Arsimi Bazë 09120

Në programin 09120 në DRAP Fier (për 14 institucionet) **plani i rishikuar i vitit 2023** në total është 4 miliard 363 milion 346 mijë lekë nga 4 miliard 688 milion 23 mijë lekë realizimi i vitit 2023, pra më i ulët, në vlerën 324 milion 678 mijë lekë.

Ky plan është celur sipas kodeve të produkteve, ku vendin kryesor e zë produkti nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar me kodin 91103AB me shumën 4 miliard 195 milion 855 mijë lekë ose 96.12 % e totalit i ndjekur nga produkti nxënës dhe mësues që u garantohet shërbimi i transportit me kod 91103AD në shumën 162 milion 431 mijë lekë ose 3.72 % nga totali, i ndjekur nga kodin 91103AE në shumën 2 milion e 510 mijë lekë ose 0.06 % i ndjekur nga kodin 91103AG në shumën 0 milion e 0 mijë lekë ose 0 % dhe të fundit me kodin M112624 në shumën 2 milion e 550 mijë lekë ose 0.06 % nga totali.

Realizimi i 4 muajve të I të vitit 2023 krahasuar me planin e celur të këtij viti në programin 09120 në total është 1 miliard 542 milion 550 mijë lekë nga 4 miliard 363 milion 346 mijë lekë plani ose 35.4 %.

Në kodin e produktit 91103AB është realizuar në shumën 1 miliard 485 milion 722 mijë lekë nga 4 miliard 195 milion 855 mijë lekë plani ose 35.4 %.

Në kodin e produktit 91103AD është realizuar në shumën 52 milion 142 mijë lekë nga 162 milion 431 mijë lekë plani ose 33.9 %. Në kodin e produktit 91103AE është realizuar në shumën 1 milion e 686 mijë lekë nga 2 milion e 510 mijë lekë plani ose 67.2 %. Në kodin e produktit 91103AG është realizuar në shumën 0 milion e 0 mijë lekë nga 0 milion e 0 mijë lekë plani ose 0 %.

Në kodin e produktit M112624 është realizuar në shumën 0 milion 0 mijë lekë nga 2 milion 550 mijë lekë plani ose 0 %.

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhteme

K.Produktit	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	P,spec Pl.	% F/Pl
91103AB	4,377,413	4,195,855	1,485,722	96.16%	35.4%
91103AD	185,832	162,431	55,142	3.72%	33.9%
91103AE	295	2,510	1,686	0.06%	67.2%
91103AG	122,764	0	0	0.00%	#DIV/0!
M112624	1,719	2,550	0	0.06%	0.0%
Totali	4,688,023	4,363,346	1,542,550	100.00%	35.4%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave:




Tabela e situacionit te shpenzimeve arsimin bazë dhe pesha specifike ndaj totalit


Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës	PBA Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti I periudhës progresive	% F / PI
600	Paga	3,680,197	4,079,819	3,545,483	1,272,468	35.89%
601	Sigurimet	612,121	665,833	642,433	212,224	33.03%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	217,660	214,523	171,020	56,435	33.00%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	176,326	132,119	1,860	1,422	76.45%
231	Investime	1,719	5,100	2,550	0	0.00%
	Totali	4,688,023	5,097,394	4,363,346	1,542,550	35.35%
600	Paga	78.50%	80.04%	81.26%	82.49%	
601	Sigurimet	13.06%	13.06%	14.72%	13.76%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4.64%	4.21%	3.92%	3.66%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3.76%	2.59%	0.04%	0.09%	
231	Investime	0.04%	0.10%	0.06%	0.00%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara për arsimin bazë janë 4 miliard 363 milion e 346 mijë lekë nga 4 miliard 688 milion e 23 mijë realizuar në 2022 ose me pakesim 7%.

Tek plani I rishikuar fondi i pagave zë peshën 81.26 %, sig.shoqërore 14.72 %, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 3.92 % , transfertat për buxhetin familiar 0.09 % dhe shpenzime kapitale 0.06%

Fondi pagave është realizuar 35.89 % ndaj planit të rishikuar, sigurimet shoqërore janë realizuar 33.03 % ndaj planit të rishikuar. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 33 % dhe shpenzimet për transfert te individet është realizuar 76.45 %, kurse shpenzimet kapitale janë realizuar 0 %.

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave:



3. Arsimi Mesëm 09230

Në programin 09230 në DRAP Fier (për 14 institucionet) plani i rishikuar i vitit 2023 në total është 1 miliard 263 milion 921 mijë lekë nga 1 miliard 245 milion 969 mijë lekë realizimi i vitit 2022, pra më i lartë, në vlerën 17 milion 952 mijë lekë.

Ky plan është celur sipas kodeve të produkteve, ku vendin kryesor e zë produkti Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë në institucionet asimorë publike me kodin 91104AA me shumën 1 miliard 242 milion 671 mijë lekë ose 98.3 % e totalit i ndjekur nga produkti Mësues të AML që përfitojnë shërbimin e transportit me kod 91104AB në shumën 17 milion 350 mijë lekë ose 1.4 % nga totali, mësues të arsimit mesëm të trajnuar për kurrikulën e re me kodin 91104AC në shumën 2 milion 200 mijë lekë ose 0.17 % nga totali, kodin A91104AE në shumën 0 milion e 0 mijë leke ose 0% dhe kodin M112629 shpenzimet kapitale 1 milion 700 mijë lekë ose 0.1 %.

Realizimi i 4 mujorit të I të vitit 2023, krahasuar me planin e rishikuar të këtij viti në programin 09230 në total është 0 miliard 410 milion 260 mijë lekë nga 1 miliard 242 milion 671 mijë lekë plani ose 33 %.

Në kodin e produktit 91104AA është realizuar në shumën 0 miliard 410 milion 260 mijë lekë nga 1 miliard 242 milion 671 mijë lekë plani ose 33 %. Në kodin e produktit 91104AB është realizuar në shumën 4 milion 409 mijë lekë nga 17 milion 350 mijë lekë plani ose 25 %.

Në kodin e produktit 91104AC është realizuar në shumën 164 mijë lekë nga 2 milion e 200 mijë lekë plani, në kodin e produktit 91104AE është realizuar në shumën 0 milion 0 mijë lekë

nga 0 milion 0 mijë lekë plani ose 0 %. ne kodin M112629 është realizuar në shumën 0 mijë lekë nga 1 milion e 700 mijë lekë plani ose 0 %

Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme:

K.Produktit	Fakti 2022	Plani 2023	Fakti 2023	P,spec Pl.	% F/Pl
91104AA	1,219,200	1,242,671	410,260	98.3%	33%
91104AB	15,336	17,350	4,409	1.4%	25%
A91104AC	23	2,200	164	0.17%	7%
A91104AE	10,580	0	0	0.0%	#DIV/0!
M112629	830	1,700	0	0.1%	0%
Totali	1,245,969	1,263,921	414,832	100.0%	33%

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave




Tabela e situacionit te shpenzimeve arsimin e mesem dhe pesha specifike ndaj totalit


Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës	PBA Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti I periudhës progresive	% F / Pl
600	Paga	1,031,595	1,144,825	1,057,971	353,122	33.38%
601	Sigurimet	173,851	187,634	183,239	56,907	31.06%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	16,187	29,665	20,623	4,573	22.17%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	23,976	10,947	388	230	59.28%
231	Investime	830	1,700	1,700	0	0.00%
	Totali	1,246,438	1,374,771	1,263,921	414,832	32.82%
600	Paga	82.76%	83.27%	83.71%	85.12%	
601	Sigurimet	13.95%	13.65%	14.50%	13.72%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1.30%	2.16%	1.63%	1.10%	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1.92%	0.80%	0.03%	0.06%	
231	Investime	0.07%	0.12%	0.13%	0.00%	
	Totali	100%	100%	100%	100%	

Fondet e rishikuara për arsimin e mesëm janë 1 miliard 263 milion 921 mijë lekë nga 1 miliard 246 milion e 438 mijë realizuar në 2022 ose me rritje 1.4 %.

Ne planin e rishikuar fondi i pagave zë peshën 83.71 %, sig.shoqërore 14.5. %, shpenzimet për mallra e shërbime të tjera 1.63 % dhe transfertat për buxhetin familiar 0.03 % dhe 231 në masën 0.13 %

Fondi pagave është realizuar 33.38 % ndaj planit të rishikuar, sigurimet shoqërore janë realizuar 31.06 % ndaj planit të rishikuar. Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 22.17 % , Trans për Buxh. Fam. & Individ u realizua 59.28 % dhe 231 në masën 0 % .

Më poshtë është paraqitja grafike e të dhënave:



Analizën e shpenzimeve 602 për 14 institucionet e DRAP Fier për 4 Mujorin e I te Vitit 2023 po e paraqesim në tabelën e mëposhtme:

	SHPENZIME 2023		J - Prill 2023			
Nr	SHPENZIMET	TOTALI	10110	09120	09230	
	Plani 602	208,444	16,800	171,020	20,624	
	Fakti 602	65,289	4,280	56,435	4,574	
1	Dieta	759	759			1.16%
2	Sherbime postare	166	166			0.25%
3	Energji ,uje	829	830			1.27%
4	Taksa vendore te bashkise	310	310			0.47%
5	Karburant	499	499			0.76%
6	Materiale kancelarie	634	634			0.97%
7	Blerje tonerash	591	591			0.91%
8	Materiale pastrimi	139	139			0.21%
9	Shpenzime të tjera gjatë vitit	75	75			0.11%
10	Riparim mjete,pjese kembimi	15	15			0.02%
11	Shërbime per mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	11	11			0.02%
12	Qera objekti	242	242			0.37%


13	Trajnim mesuesish AMU per kurrik.e re	1,850	-	1,686	165	2.83%
14	Materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	10	10			0.02%
15	Transport mesues, nxenes	59,550	-	54,749	4,409	91.21%

Nga të dhënat e tabelës shohim që nga 65 milion 289 mijë lekë total të realizuara në 4 Mujorin e I te Vitit 2023, 59 milion 550 mijë lekë e zënë transporti i mësuesve dhe nxënësve, kurse pjesën tjetër e zënë shpenzimet e tjera operative.

Programi	TOTALI	Administrata	A.Baze	A.Mesem
Fakti 602	65,289	4,280	56,435	4,574
Pesha specifike		7%	86%	7%

Nga të dhënat e tabelës duket qartë që peshën specifike më të madhe në realizimin e shpenzimeve e ka arsimi bazë me 86%, i cili pasohet nga programim menaxhimi me 7% dhe në fund Arsimi i mesëm me 7%.

Po e paraqesim grafikisht realizimin sipas programeve:



Pesha specifike e zërave të shpenzimeve korente 602 ndaj totalit të realizuar po e paraqesim me tabelë.

Totali	100%
Dieta	1.2%
Sherbime postare	0.3%
Energji ,uje	1.3%
Taksa vendore te bashkise	0.5%
Karburant	0.8%
Materiale kancelarie	1.0%
Blerje tonerash	0.9%
Materiale pastrimi	0.2%
Shpenzime të tjera gjatë vitit	0.1%

Qera objekti	0.4%
Transport Materiale	0.0%
Trajnim mesuesish AMU per kurrik.e re	2.8%
Transport mesues, nxenes	90.6%
Totali	100%

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin:

P.S.BNJ.SH.S
Bajame Skënderaj



DREJTORI

Flutura Meçaj

